REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nri y) / prot

Koplik miifZ / ol / 2024

V E N D I M

*Nr 9 date 18 / 01 / 2024*

Keshilli Baslikiak Malesi e Madhe në mbledhjen e tij te dates 18.01.2024, mbeshtetur në aktin normativ nr 3 date 15.03.2020 neni 5, me propozim te Kryetarit te Baslikise,në mbeshtetje te Ligjit nr.139/2015."Per veteqeverisjen vendore"neni 9 pika 1.7/a,te Ligjit 112/2013"Per dekoratat,titiijt e nderit,medaljet dhe titujt vendore te nderit lië Republiken e Shqipgrisg"seksioni 3 neni 14,neni 15 pika 1/a,pika 2/b.neni 16/1.

VKM Nr.861 date 10.12.2014 Per miratimin e rregullave te hollSsishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e niedaljeve dhe titujve vendor te nderit në Republiken e Shqiperise.

**VENDOSI**

1. T'i akordoje titullin "Qytetar Nderi "Z. Xheinal Myrto Brahaj me motivacionin:

"Pgr punën dhe perkushtimin e tij si nje qytetare bashkekohore, si ushtarak dhe drejtues i dalluar ng shumg institucione ushtarake e organizata shoqgrore. Pgr?ues i traditatave e vlerave mg tg larta malgsore e intelektuale duke lartgsuar kurdoherg trevgn tong Malgsi e Madhe[11].

2. Pgr zbatimin e kgtij vendimi ngarkohet Sektori i Shgrbimeve tg Brendshme.
3. Ky vendim hyn ng fuqi mgnjeherg

KRYETAR
IlirHalaj

SEKRETAR
Emirjan Hasmujaj
Miratuarme 18.0f.2024
VotaPro 16
Vota Kunder 10
Vota Abstenim 3
Zbardhur me datg 19.01.2024

Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-maikbashkiamalesiemadhe@hotmail.com

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA MALESI E MADHE**

**Nr/13 .prot** **Koplik më: 11/01/2024**

## Keshillit te Bashkise Malesi e Madhe
## Propozim për dhenie titulli " Qytetare Nderi " i Bashkise Malesi e Madhe z. Xhemal Myrto Brahja










Xhemal Myro Brahja lindur me 24.07.1950 në fshatin Gruemire Qesme, Njesia Administrative Gruemire, Bashkia Malesi e Madhe. Pasi mbaroi arsimin e nivelit te ulet dhe te mesem shkon per arsimim te nivelit te larte ushtarak per oficer ne Shkollen e Bashkuar dhe me vone ne Akademine Ushtarake ne Tirane. Ne vitet 1972 titullohet Oficer ne Tirane dhe per 35 vite ka kryer detyra te ndryshme ne reparte autonome te Shtabit te Pergjithshem te Ushtrise Shqiptare, gjithmone ne Tirane, ne Qendrat e Nderlidhjes i specializuar si Nderlidhes Radiotelegrafist.
Per pune te mire e rezultate te larta eshte vleresuar nga instancat eprore me urdhra, medalje e vleresime te ndryshme te kohes nga repartet, Ministria e Mbrojtjes dhe Procediumi I Kuvendit Popullor te kohes. Gjithashtu ka kryer kurse trajnime e specializime te ndryshme ne funksion te kryerjes se detyrave.

- Pas daljes ne lirim (pension), eshte angazhuar fillimisht ne Shoqaten e Pensionisteve, i ngarkuar ne sektorin e mardhenieve me jashte te shoqates. Me vone eshte angazhuar ne Shoqaten e Ushtarakeve ne reserve e lirim me qender ne Tirane per disa vite si dhe angazhuar prej 18 vitesh ne Organizaten e Veteraneve dhe Pasardhesve te LANC-it "Nder i Kombit" i zgjedhur ne funksione te ndryshme.
- Ështe anetar dhe nje nga themeluesit e Shoqates Atdhetare Patriotike e Kulturore “Sofra e Malesise se Madhe” me qender ne Tirane e nga viti 2015 e ne vazhdim eshte zgjedhur dhe vazhdon te kryej detyren e Kryetarit te kesaj Shoqates ku ne gjirin e saj ka rreth 5300 anetare ne Tirane, Shqiperi dhe jashte saj duke spikatur në organizimi e aktiviteteve dhe kultivimi I traditave tona malesore tek brezat e ri si dhe bashkepunimin me organet e pushtetit vendor si dhe shoqatat e organizatat homologe brenda territorit te Malesise së Madhe e jashte territorit dhe vendit tone per te cuar perpara emrin e madh qe ka Malesia e Madhe.
- Ështe botues i dy librave: 1 – “Ne kerkim te rrenjve historike te fisit Brahja” dhe 2 – "Gruaja e zgjuar e shume fisnike”.
- Prej vitesh ka punuar e jetuar ne Tirane, por kurre nuk e ka harruar vendlindjen dhe treven e tij Malesi e Madhe.
- Eshte vleresuar me urdhra, medalje e tituj te ndryshem ku disa nga keto jane :

1 –Nga Presidiumi I Kuvendit Popullor ne Korrik 1988 me Urdhrin e Sherbimit Ushtarak.
2 –Titullin “Anetar Nderi i Organizates se Veteraneve dhe Pasardhesve te Tiranes" me Prill 2005.
3 –Titullin me te larte te Komitetit Kombetar te Organizates se Veteraneve dhe Pasardhesve te Popullit Shqiptar “Nder i Organizates se Veteraneve te LANC-it te Popullit Shqiptar" Tetor 2011.
4 – Jam nderuar nga Shoqata Patriotike Kulturore "Myslym Peza” Tirane me vleresimin Besnik ndaj vlerave qe shpreh e mbron kjo shoqate.

Per gjitha sa thame më larte i propozohet Keshillit Bashkiak Malesi e Madhe ti jepet titulli “ Qytetare Nderi “ i Bashkise Malesi e Madhe me

**motivacion:**

*"Per punën dhe perkushtimin e tij si nje qytetare bashkekohom, si ushtarak dhe drejtues i dalluar ne shume institucione ushtarake e organizata shoqerore. Pergues i traditatave e vlerave me te larta maiesore e intelektuale duke lartesuar kurdohere treven tone Malesi e Madhe".*

KRYETARBASHKIE

TONIN MARINAJ

Shenini: Propozuar nga Shoqata Atdhetare, Patriotike e Kulturore “Sofia e Malesise së Madhe” me qender ne Tirane me Date 23.11.2023 e Nr.prot. 3234